

Hapen regjistrimet për kurset e gjuhës dhe kulturës kineze pranë Institutit Konfuci- UT.

Instituti Konfuci në Universitetin e Tiranës hap regjistrimet për studentët të cilët janë të interesuar të mësojnë gjuhën dhe mbi kulturën kineze pranë këtij Instituti.

Kurset zhvillohen në ambientet e Godinës “Liria”, Qyteti Studenti, dy herë në javë nga 120 minuta. Mësimi i gjuhës kineze zhvillohet në anglisht-kinezisht dhe është falas për të gjithë studentët e Universitetit të Tiranës.

Për t’u regjistruar në këtë kurs jeni të lutur të plotësoni formularin e regjistrimit online në faqen zyrtare web: www.ciut.edu.al.

Afati i fundit për regjistrim është data **19 Tetor 2018**.

Për çdo pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni në faqen e Web-it të Institutit Konfuci-UT ose në rrjetin social Facebook “Institutit Konfuci në Universitetin e Tiranës”.

Suksese!